



Nr. 23 Prot
Dt. 09/06/2014

REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHITËTORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3 Tel: ++35542200245; Fax: ++3554251388

Nr. 4488 Prot.

Tiranë, më 5/6/2014

Drejtuar: SH.A " AGJENSIA DETARE TAULANTIA"

DURRËS

Lënda: Dërgohet urdhri Nr. 308 datë 2.6.2014.

Bashkëlidhur ju dërgojmë për zbatim Urdhrin Nr. 308, datë 2.6.2014 të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, "Për prishjen e shoqërisë " Agjensia Detare Taulantia" Durrës.

FREDERIK SEITI

SEKRETARI PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TREGTISË
DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS SHITËTORE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

URDHËR

Nr. 308 Datë 2/6/2014

PËR

PRISHJEN E SHOQËRISË " AGJENSIA DETARE TAULANTIA" SH.A, DURRËS

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit I të Ligjit Nr. 8885, datë 22.4.2002, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.4.1995 " Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte të tjera ligjore, dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë " Agjensia Detare Taulantia" sh.a Durrës,

URDHËROJ:

1. Prishjen e shoqërisë " Agjensia Detare Taulantia" Durrës dhe shpalljen e saj në likuidim.
2. Likuidator i shoqërisë emërohet Z. Kastriot Muka, aktualisht Administrator i kësaj shoqërie.
3. Të hartohet bilanci i likuidimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 " Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
4. Zj. Anita Pulaj, Eksperte Kontabël e Autorizuar, të kryejë certifikimin e Bilancit të likuidimit.
5. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ

